



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA ND RYSHE**

29 qershor 2018, Prizren

**KOMUNIKATË
Shenjzimi dhe reklamimi kaotik në Qendrën Historike të Prizrenit**

EC Ma Ndryshe sot ka organizuar performancën publike “Shenjzimi dhe reklamimi kaotik në Qendrën Historike të Prizrenit”. Përmes këtij aktiviteti EC ka shprehur shqetësimin lidhur me shenjzimin për trashëgiminë kulturore të patrajtuar nga shteti dhe reklamimin e pakontrolluar, që si rezultat kanë sjellë një degradim vizuel të Qendrës Historike të Prizrenit.

Kësaj performace publike i ka paraprirë një hulumtim, të cilin EC Ma Ndryshe e ka bërë për problematikën në fjalë. Nga ky hulumtim janë identifikuar mbi 200 ndërtesa që kanë tabela dhe reklama që janë në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit. Ndërkohë përfitimi i Komunës nga taksat për reklama përgjatë kësaj periudhe ka qenë 0 euro. Vendosja e reklamave të partive politike, bizneseve e organizatave kryesisht është bërë pa pëlqim të organeve të trashëgimisë kulturore.

Ky hulumtim është marrë specifikisht me identifikimin e fenomenit të degradimit vizuel dhe adresimin e përgjegjësive fillimisht institucionale të Qendrës Historike të Prizrenit dhe nuk pretendon të denigrojë apo dëmtojë bizneset e veçanta që janë paraqitur përmes reklamave të tyre.

Si mangësi që adresohet përmes kësaj performace është mungesa e standardizimit nga shteti për sinjalistikë rrugore, shenjzim e tabela interpretuese për lokalitete të trashëgimisë. Sinjalistika rrugore, shenjzimi i lokaliteteve të trashëgimisë dhe tabelat interpretuese të këtyre lokaliteteve janë pjesë përbërëse, në mos esenciale të promovimit të një lokaliteti të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Kosova në përgjithësi në krahasim me shtetet e rajonit është shumë prapa sa i përket rregullimit të kësaj fushe, andaj kjo është edhe një thirrje tjetër që i bëhet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë kulturore dhe udhëzuesin për komunat e Kosovës ku do të përcaktohej formati teknik i shenjave për sinjalistikë rrugore dhe atë këmbësorike.

Komuna e Prizrenit udhëzohet që ta bëjë përditësimin dhe përmirësimin e vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit duke i shtuar disa nene përkatëse dhe duke qartësuar disa të tjera. Ky vendim duhet të përcillet edhe me një udhëzues grafik për shenja dhe reklama në Qendrën Historike të Prizrenit në mënyrë që të lehtësohej sidomos puna për biznese. Hulumtimin e plotë dhe rekomandimet në detaje mund ta gjeni këtu: http://ecmandryshe.org/repository/docs/180629091001_Reklammat_QHPZ.pdf

EC është në dijeni mbi hapat e fundit të ndërmarrë nga komuna e Prizrenit lidhur me lirin e hapësirave të uzurpuara publike dhe largimin e disa reklamave pa leje andaj edhe e përgëzon Komunën

për këto veprime. Në të njëjtën kohë EC njofton që edhe vendosja e reklamës nga ana jonë në urën e Arastës është realizuar në shenjë proteste pa leje dhe fton autoritetet lokale ta bëjnë largimin e saj duke vazhduar tutje me të gjitha shenjëzimet dhe reklamimet brenda Qendrës historike të Prizrenit që bien në kundërshtim me ligjin për këtë zonë.

Ky aktivitet u organizua ne kuadër të projekti "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" i cili përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë.

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771